

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Pothuajse katër vjet më parë, në shtator të viti 2016, si ambasadori i gjashtë Slloven, ia dorëzoja letrat kredenciale kryetarit të atëhershëm të Republikës së Maqedonisë, dr. Gjorge Ivanov. Disa ditë më parë, realizova vizitë zyrtare me kryetarin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dr. Stevo Pendarovski dhe me këtë përfundova misionin tim diplomatik. Ndërkohë, kanë kaluar dyzet e shtatë muaj shumë dinamike, të lodhëshme dhe të përgjegjshme, por edhe një forcë e një pune interesante diplomatike në një shtet që kam njohur me dekada. Sllovenia ishte e para që ratifikoi protokollin për anëtarësimin në NATO dhe gjithmonë është angazhuar me vendosmëri për caktimin e datës për fillimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Në vitin 2019, realizuam gjithsej katërmëdhjetë vizita zyrtare midis dy vendeve, që paraqet një rekord i jashtëzakonshëm. Tregtia dhe shkëmbimi i mallrave si dhe investimet midis dy vendeve po rritet gjatë gjithë kohës. Studentët maqedonas përbëjnë grupin më të madh të studentëve në Slloveni; ka më shumë se një mijë prej tyre tashmë. Praktikisht ekzistojnë tregues të panumërt që dëshmojnë miqësinë, afeksionit dhe bashkëpunimin e ndërsjellë midis dy vendeve tona dhe njerëzve në tërësi.

Personalisht, mandati im u shënua me faktin që isha ambasador në shtetin ku kam shërbyer ushtrinë disa dekada më parë. Dhe jam shumë mirënjohës që u bëra qytetar nderi i qytetit të Shtipit pikërishtë mu për këtë këtë. Jam veçanërisht i nderuar poashtu edhe për marrjen e çmimit të nderuar Racin në vitin 2019.

Do të doja të falënderoja përzemërsisht të gjithë ata me të cilët kam pasur mundësinë që ndër këto vite t'i njohtojë, të bisedojë dhe të bashkëpunojë, të falenderohem për dashamirësinë e jashtëzakonshme dhe respektin që kam pranuar. Njerëzit mësojnë gjatë gjithë jetës dhe më gëzonë fakti që përmes punës së palodhshme të tre shoqatave sllovene, profesoreshës Lidija Arizankovska dhe mësueses së orëve plotësuese Sonja Dolzhan u mundësua që gjuha sllovene të kultivohet dhe më tej në vend. Falënderime të veçanta ju shpreh stafit tim në ambasadë. Ky staf është më i miri në karrierën time dhe pa punën e tyre nuk do të ishim kaq shumë të suksesshëm.

Në fund dëshirojë që të gjithëve të ju uroj mirëqenie, shëndet të mirë me shpresa që në të ardhmen të kemi mundësinë të takohemi dhe bisedojmë përsëri.

Prof. dr. Milan Jazbec

Ambasador